INFORMACION

Drejtuar: Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

Nga : Vullnetare Çela, Audituese Ligjore

Tirane

Me Vendimin për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e Audituesve Ligjore, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për periudhen janar – dhjetor 2018, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, sipas Vendimit nr. 112, date 27.03.2019 dhe kontrates Nr.1354/1 Prot, date 24.04.2019, më ka emëruar Audituese Ligjore në subjektin zgjedhor Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise.

Unë, me të lidhur kontratën me KQZ fillova misionin e auditimit duke njoftuar subjektin per emerimin tim ne kryerjen e misionit per auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per vitin 2018 . Sipas deklarates se leshuar nga Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise kjo parti, për periudhën janar – dhjetor 2018, nuk ka perfituar fonde nga buxheti i shtetit , donacione nga të tretet dhe nuk ka kryer shpenzime për këtë periudhë ushtrimore.

Bashkelidhur eshte deklarata e leshuar nga Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Puntoreve te Shqiperise dhe e firmosur nga Kryetari i kësaj partie, Z.Kadri Isufaj.

Ju faleminderit për bashkepunimin.

Audituese Ligjore

Vullnetare Çela

Nr Liç 153

Nr- 15-Prot, Tirane,me 17.05.2019

**DEKLARATE:**

**Drejtuar**:znj.**Vullnetare CELA-Eksperte Kontabel**(Komisionit Qendror Zgjedhjeve)**Tirane,**

**Lenda:Dergim Informacioni/Deklarate** mbi shpenzimet e kryera nga **Partia** per **Mbrojtjen** e te **Drejtave** te **Puntoreve** te **Shqiperise(PMDPSH)**apo te ardhura nga **buxheti i shtetit** ose/apo nga **pale te treta**,ose nga vete **personi juridik** per periudhen **01.01.2018 - 31.12.2018.**

**1-Me** ane te ketij **dokumenti/deklarate**,ju **informojme**,se **Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Puntoreve te Shqiperise** me **Kryetar** zotin **Kadri ISUFAJ**,nuk ka marre asnje **financim** as nga **buxheti** i **shtetit**,as nga **persona/pale te treta**,apo/ose **donator** te **ndryshem**,per gjithe vitin kalendarik **2018.**

**2-Partia** per **Mbrojtjen e te Drejtave te Puntoreve te Shqiperise**,eshte **regjistruar** prane **Komisionit Qendror te Zgjedhjeve**,me **vendimin** Nr.65,date 20.03.2019(pas kerkeses tone Nr-1316-Prot,date 06.03.2019)per te **marre pjese** ne **zgjedhjet** per **organet e qeverisjes** vendore te dates 30.06.2019,ndresa por per shkaqe te ndryshme **objektive** dhe **subjektive**,ishte regjistruar,por nuk ka marre pjese ne **zgjedhjet** per **Kuvendin e Shqiperise**,date **25.06.2017.**

**3-Sqarojme** se,qe nga **zgjedhjet** per **Kuvendin e Shqiperise** te **mbajtuar** ne vitin **2005**(periudhe ne te cilen **PMDPSH**,mori nga **buxheti i shtetit** nje **shume** prej **315.000** leke)ne asnje nga zgjedhjet e me pasme(*vendore apo parlamentare*)**PMDPSH**,nuk ka perfituar/nuk ka marre asnje **leke** nga **buxheti i shtetit**,ose nga **pale te treta**,apo **donateore** te **ndryshem**,sic **random kane vepruar parti te caktuara politike**(parlamentare ose jo parlamentare).

**4-Kete informacion/deklarate** e **derguam**,pas **kerkeses** se znj.**Vullnetare CELA-Eksperte Kontabel**,e caktuar nga **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**,per **auditimin** e **fondeve** te **shpenzuara** nga **PMDPSH**,per vitin 2018(nga data 01.01.2018 deri me date 31.12.2018).

**5-Per** te gjitha sa parashtruam/deklaruam me lart,mbajme pergjegjesi ligjore,nese vertetohet e kunderta e ketyre deklarimeve,lidhur me financimet e cfaredo lloji,ne emer dhe per **llogari** te **PMDPSH.**

**KRYETARI:**

Av.Kadri ISUFAJ

PARTIA PER MBROJTJEN E TE DREJTAVE TE PUNTOREVE TE SHQIPERISE P.M.D.P.SH 2002 TIRANE

Rruga: "George W. Bush", Nr. 3, Kati 2-të, Zyra 110, Kutia Postare, Nr. 7427,Tirana - Albania
TelFax: +355 4 2235659, Fax (rezerve): +355 4 2246912, Mobile: +355 684001720
E-mail: pmdp_al@yahoo.com, E-mail: pmdp_al2002@hotmail.com E-mail: kisufaj@gmail.com